

PËR NJË SHOQËRI TË BARABARTË DHE PA DHUNË

MBËSHTETUR NGA



Prezenca e OSBE-së në Shqipëri



MINISTRIA E PUNËS
DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA
DREJTORIA E POLITIKAVE TË SHANSEVE TË BARABARTA

Rruga e Kavajës, Tiranë

Tel: + 355 4 22 50 51

web-site: www.mpcs.gov.al

e-mail: dpsheb.albania@gmail.com

PËRMBAJTJA

- MIRATOHET RAPORTI I PARË I PROGRAMIT TË BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE**
1. a. Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, 3 Qershor 2009
- MBËSHTETJA E DONATORËVE FAKTORI I RËNDËSISHËM NË ARRITJET E BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE**
2.a. Takimi i III-të i Grupit Sektorial të Donatorëve (GSD-së), që adreson rekomandime dhe sfida për të ardhmen
- PËRFUNDON PROCESI I TRAJNIMIT NË NIVEL VENDOR TË NËPUNËSVE TË BARAZISË GJINORE**
3. a. Takimi i parë Kombëtar i Nëpunësve të Barazisë Gjinore në Shqipëri
- NË PËRFUNDIM DRAFTI I PARË I TREGUESVE KOMBËTARË TË BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE**
4. a. Takimi i II i Grupit Ndërinstitucional të Punës për treguesit gjinorë dhe të dhunës në familje
4. b. Takimi i OJF-ve mbi diskutimin e çështjeve kryesore dhe i draft listës të treguesve gjinorë dhe të dhunës në familje
4. c. Takim midis MPÇSSHB, UNIFEM-it dhe ekspertëve mbi draft listën e treguesve gjinorë dhe të dhunës në familje
- LANÇOHET VROJTIMI I PARË KOMBËTAR "DHUNA NË FAMILJE NË SHQIPËRI"**
5.a. Dhuna në familje në Shqipëri: Studimi kombëtar me bazë popullatën, botim i Institutit të Statistikave (INSTAT) në bashkëpunim me MPÇSSHB për rezultatet e vrojtimit kombëtar me bazë popullatën
- TAKIM ME STUDENTËT E DEPARTAMENTIT TË SOCIOLOGJISË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE**
- FILLIMI I CIKLIT TË TRAJNIMEVE NË TË GJITHË VENDIN MBI LIGJIN NR. 9970 "PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI" (LBGJ) DHE KONVENTËN PËR ELEMENIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRUAS (CEDAW)**
7 .a. Trajnimi për Trajnerë (ToT) për LBGJ dhe CEDAW
- MOMENTE PUNE NE DREJTORINE E POLITIKAVE TE SHANSEVE TE BARABARTA**

1. MIRATOHET RAPORTI I PARË I PROGRAMIT TË BARAZISË GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

1. a. Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGJ), 3 Qershor 2009

Më datë 3 Qershor 2009 në mjediset e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Qëllimi i takimit: Të zhvillohet mbledhja e parë e KKBGJ-së dhe të miratohet Raporti Vjetor i Zbatimit të Objektivave të SKBGJ/DHF për vitin 2008.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ) u ngrit me Urdhër të Kryeministrit Nr. 3 datë 8.1.2009 si organ këshillimor për drejtimin, përcaktimin dhe zhvillimin e politikave shtetërore për barazinë gjinore. Këshilli kryesohet nga Ministri i MPÇSSHB dhe në përbërje të tij ka 9 zv/ministra dhe 3 përfaqësues nga shoqëria civile.

Mbledhja u hap nga Z. Viktor Gumi, Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili, pasi u uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrësve theksoi se miratimi i Ligjit Nr. 9970 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" ngarkon MPÇSSHB si autoritetin përgjegjës për barazinë gjinore.

Në mbledhjen e parë Ministri i MPÇSSHB paraqiti raportin e zbatimit të objektivave SKBGJ/DHF për vitin 2008, punën e bërë deri tani, arritjet kryesore dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në të ardhmen. Disa prej këtyre arritjeve të politikave gjinore konsistojnë në:

- Fuqizimin e mekanizmit institucional për barazinë gjinore dhe dhunën në familje përmes: a) Ngritjes së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGJ); b) Strukturës së re për Masat ndaj Dhunës në Familje; c) Hedhjes së hapave të parë në ngritjen e Sekretariatit Teknik

për Monitorimin e SKBGJ/DHF; d) Institucionalizimit të rrjetit të nëpunësve gjinorë dhe dhunës në familje në nivel qendror dhe vendor sipas Ligjit Nr.9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri".

- Ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës Ndërshtetërore (GPNI) si grup këshillimor në sigurimin e statistikave gjinore dhe përcaktimin e treguesve të harmonizuar gjinorë në mbështetje të politikave dhe monitorimit të barazisë gjinore në Shqipëri sipas angazhimeve kombëtare endërkombëtare për barazinë gjinore në çdo nivel të qeverisë.
- Hartimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje si: a) Miratimi i ligjit Nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri"; b) Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9669 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"; c) Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- Organizimin e fushatave ndërgjegjëse në të gjithë vendin mbi çështjet gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje.

Më pas u kalua në raportime të zv/ministrave dhe përfaqësuesve të Ministrive përkatëse lidhur me zbatimin e objektivave të SKBGJ/DHF për vitin 2008.

Në vijim, diskutuan edhe përfaqësues të shoqërisë civile si anëtarë të KKBGJ, të cilët në diskutimet e tyre përgëzuan DPSHB për raportin dhe arritjet e prezantuara duke theksuar se roli i arsimimit të vajzave dhe grave duhet të jetë i balancuar për barazinë gjinore dhe dhunën në familje.

Të gjithë anëtarët pas diskutimeve miratuan njëzëri raportin progresiv të zbatimit të SKBGJ/DHF për 2008.

2. MBËSHTETJA E DONATORËVE, FAKTORI I RËNDËSISHËM NË ARRITJET E BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

2.a. Takimi i III i Grupit Sektorial të Donatorëve (GSD-së) adreson rekomandime dhe sfida për të ardhmen

Takimi i III-të i Grupit Sektorial të Donatorëve u zhvillua më 22 Prill 2009 nën drejtimin e Zj. Marieta Zaçe, Zëvendësministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth arritjeve në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje gjatë 4 viteve të fundit dhe në mënyrë të veçantë në zbatimin e SKBGJ/DHF 2007-2010, si edhe në kontributin dhe mbështetjen teknike dhe financiare të donatorëve për realizimin e objektivave të kësaj strategjie.

Drejtorja e Drejtorisë të Politikave të Shanseve të Barabarta, Zj. Anna Xheka, në fjalën e saj, pas një prezantimi të shkurtër të rolit mbështetës të donatorëve në zbatim të objektivave të SKBGJ/DHF si dhe të sfidave të ndeshura, u ndal në një sërë rekomandimesh të rëndësishme për zhvillimin më tej të këtij bashkëpunimi. Këto rekomandime janë si vijon:

- Vendosijen e një linje bashkëpunimi dhe raportimi me DPSHB për ndikimin e projekteve të OJF-ve të financuara nga donatorët për fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.
- Krijimin e një baze të dhënash me emrat e personave të trajnuar me qëllim që ky kontigjent të mund të përfshihet në programet apo projektet e mëtejshme të DPSHB lidhur me integrimin gjinor në nivel qendror dhe lokal.
- Rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional, veçanërisht në lidhje me projektet dhe ndihmën e huaj në fushat përkatëse si: arsimit,

shëndetësia, por të lidhura realizimin e objektivave të SKBGJ/DHF.

- Realizimin e takimeve të herëpashërëshme dhe konsultimin e donatorëve me DPSHB-në në lidhje me subjektet që mbështeten prej tyre për fusha të caktuara që janë të lidhura me zbatimin e SKBGJ/DHF.
- Sigurimin e mbështetjes nga Grupi Sektorial i Donatorëve për iniciativën rajonale të Komisionit Ekonomik UNECE-s, për statusin e gruas si sipërmarrëse dhe kapacitetin e saj drejtues.

Në këtë takim, në lidhje me matricat e raportimit, u ra dakort që MPÇSSHB dhe DEBASKON të bashkëpunojnë në përmirësimin e matricës ekzistuese e cila më pas do të qarkullohet tek të gjithë pjesëmarrësit, të cilët mund të japin mendimin e tyre përfundimtar duke kontribuar në finalizimin e matricës raportuese të donatorëve.

Përfaqësuesi i Departamentit të Bashkëpunimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Indrit Faja, diskutoi mbi termat e referencës të Grupit Sektorial të Donatorëve (GSD), të cilët do të jenë orientuese për punën që do të bëjnë. U ra dakort që çdo koment për termat e referencës së GSD t'i kalojnë njëherë Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe Ndihmës së Huaj (DSDC) dhe MPÇSSHB në fund të muajit maj. Ai prezantoi dhe kalendarin e takimeve të GSD për vitin 2009.

Në fund të takimit donatorët dhe partnerët e tjerë ndërkombëtare shprehën gadishmërinë për mbështetjen e mëtejshme të programit të qeverisë shqiptare në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje.

3. PËRFUNDON PROCESI I TRAJNIMIT NË NIVEL VENDOR TË NËPUNËSVE TË BARAZISË GJINORE

3.a. Takimi i parë kombëtar i nëpunësve të barazisë gjinore në Shqipëri¹

Takimi i parë kombëtar i nëpunësve të barazisë gjinore të Bashkive në Shqipëri u mbajt më 27 - 28 Prill 2009, në Tiranë. Ky takim u organizua në kuadër të projektit "Barazi në qeverisje" (BnQ) dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta/Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta.

Qëllimi i këtij takimi: Të mbledhë të gjithë nëpunësit e barazisë gjinore nga Bashkitë e Shqipërisë si dhe bashkëpunëtorët kryesorë të përfshirë në fushën e çështjes së barazisë gjinore në vend.

Në takim morën pjesë 42 pjesëmarrës – duke përfshirë këtu punonjës të Bashkive, punonjës civilë të qeverisë qendrore dhe përfaqësues të donatorëve.

Përveç shpërndarjes së informacionit kyç mbi çështjet ligjore dhe detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet e PFBGJ, takimi u pa nga këndvështrimi i fuqizimit të pjesëmarrësve në

rolin e tyre si avokatë të barazisë gjinore dhe të nxitjes së rrjeteve rajonale.

Objektivat specifike të takimit:

- të shpjegojë dhe sigurojë informacion mbi ligjet që rregullojnë barazinë gjinore dhe dhunën në familje;
- të diskutojë rëndësinë e Ligjit "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" për qeverisjen vendore dhe punën e nëpunësve të barazisë gjinore;
- të shpërndajë informacion mbi objektivat e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje (SKBGJ & DHF);
- të përcaktojë kompetencat e nëpunësve të barazisë gjinore dhe rolin e tyre në pushtetin vendor (Bashki);
- të rrisë njohuritë rreth përdorimit të treguesve specifike lidhur me barazinë gjinore;
- të identifikojë nevojat aktuale të nëpunësve të barazisë gjinore dhe perspektivat e së ardhmes;
- të krijojë një rrjet kombëtar të nëpunësve të barazisë gjinore.

Metodologjia e përdorur u bazua mbi qasjen pjesëmarrëse. U përdorën shumë metoda të ndryshme si: rrahje mendimesh, diskutime



27-28 Prill Takimi i parë kombëtar i nëpunësve të barazisë gjinore

¹ Termi "nëpunës të barazisë gjinore" mund të gjendet në literaturë edhe si "pikat fokale të barazisë gjinore" në Shqipëri.

në grupe të mëdha, punë në grupe të vogla, prezantime të punëve në grup etj. për të siguruar pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve. Megjithatë, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin punonjës të bashkive të cilët kishin një pozicion, kryesisht në sektorin social.

Brenda dy ditëve u krijua një atmosferë miqësore mes grupeve të punës. Pjesëmarrësit nga Bajram Curri, Kukësi, Kopliku, Shkodra, Lezha, Rubiku, Rrësheni, Burreli, Klosi, Bulqiza, Peshkopia dhe Kruja kishin marrë pjesë në trajnimin specifik për çështjet e barazisë gjinore në vazhdimësi të projektit "Barazi në Qeverisje". Të tjerët kishin qenë pjesë e seminareve në nivel rajonal mbi Ligjin "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" dhe Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri".

Takimi vazhdoi me prezantime nga diskutantë të ndryshëm mbi strukturën e çështjeve ligjore për barazinë gjinore dhe rëndësinë e tyre për qeverisjen vendore. Çështjet e diskutuara renditen më poshtë:

- Legjislacioni lidhur me Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje – kuptimi i tij për qeverisjen vendore
- Detyrate Nëpunësve Vendorë të Barazisë Gjinore (NVBGJ) si dhe mbi rëndësinë e ngritjes së një rrjeti të NVBGJ

- Strategjia Kombëtare mbi Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje 2008-2010"
- Treguesit Gjinorë dhe të dhunës në familje, "Diskutimi i Draftit Paraprak".

Rekomandime shumë konkrete për takimin tjetër të Nënpunësve Vendorë të Barazisë Gjinore NVBGJ:

- Kryetarët e bashkive duhet të marrin pjesë në konferenca dhe takime të këtij lloji;
- Përpara se të organizohet konferenca e dytë NVBGJ në nivel vendor duhet të ndërmerret një fushatë ndërgjegjësimi mediatike mbi barazinë gjinore dhe dhunën në familje;
- Përpara se të organizohet konferenca e dytë NVBGJ në nivel vendor duhet të përfundojë emërimi zyrtar i NVBGJ pranë bashkive;
- Në takimin e ardhshëm, NVBGJ-ve duhet t'u kërkohet të prezantojnë raporte konkrete se çfarë kanë bërë për barazinë gjinore në Bashkinë e tyre që prej takimit të parë;



27-28 Prill Takimi i parë kombëtar i nëpunësve të barazisë gjinore

- Takimi i dytë NVBGJ duhet të fokusohet në punën e përditshme të NVBGJ, zgjidhjet praktike dhe shembuj për përmirësimin e punës;
- Të rritet shpeshtësia e takimeve me tematikë të njëjtë;
- Të përdoren takimet e NVBGJ si platforma për të shkëmbyer përvoja dhe sidomos për të prezantuar, diskutuar dhe zhvilluar praktikatat më të mira.

Puna e bërë në këtë takim të parë kombëtar të NVBGJ mund të konsiderohet si një prej hapave të parë të nevojshëm për krijimin e një rrjeti funksional rajonal të NVBGJ-ve në Shqipëri.

4. NË PËRFUNDIM DRAFTI I PARË I TREGUESVE KOMBËTARË TË BARAZISË GJINORË DHE DHUNËS NË FAMILJE

4.a. Takimi i II i grupit të punës ndërinstytucional (GPNI) për treguesit gjinorë dhe të dhunës në familje.

Në datën 29 Prill 2009 në MPÇSSH-B u organizua takimi i II-të i GPNI-së në mbledhjen e statistikave gjinore dhe në përcaktimin e treguesve të ndjeshëm gjinorë. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe miratimi i planit të punës për finalizimin e treguesve të harmonizuar gjinorë.

Takimi u hap nga Zj. Marieta Zaçe, Zëvendësministre e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila pas falënderimit të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve qendrore për pjesëmarrjen e tyre në takimin e dytë të GPNI-së, u ndal në prezantimin e planit të punës në lidhje me procesin e finalizimit të listës së treguesve të harmonizuar gjinorë.

Përfaqësuesja e UNIFEM-it në Shqipëri, diskutoi edhe një herë shkurtimisht për seminarin e organizuar për përpilimin e draft listës të treguesve të harmonizuar gjinorë që iu referuan 8 fushave kryesore dhe në fjalën e saj theksoi se lista e treguesve është ende

në fazën e një skice dhe finalizimi i kësaj liste nënkupton shumë punë dhe shumë aktivitete që duhet të realizohen brenda një kohe të shkurtër kohore, që mendohet të jetë fundi i qershorit.

Më pas u kalua në çështjen e dytë të takimit ku Zj. Anna Xheka Drejtore e DPSHB shtroi domosdoshmërinë e integritit të treguesve të harmonizuar me procesin monitorues brenda atyre ekzistuese. Gjithashtu aprovimi dhe mbështetja nga personat vendimmarrës në me angazhimin e Nënpunësve Vendor të Barazisë Gjinorë të DPSHB-së për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, në bashkëpunim me ekspertët e statistikave të institucioneve përkatëse dhe një eksperti kombëtar, për verifikimin e të dhënave.

Në fund të takimit u vendos që ekspertët e përzgjedhur nga UNIFEM-i në bashkëpunim me DPSHB-në të organizojnë në dy javët e para të qershorit takimet me pikat e kontaktit të ministrive për çështjet gjinore dhe përfaqësues të Drejtorive të Monitorim & Analizës në ministritë dhe institucionet përkatëse për skanimin listës së treguesve të harmonizuar gjinorë duke iu referuar strategjive ndërsektoriale si dhe detyrimeve që rrjedhin nga dokumentat ndërkombëtarë për të siguruar një harmonizim të tyre.

4.b. Takimi i OJF-ve mbi diskutimin e çështjeve kryesore dhe i draft listës së treguesve gjinorë dhe të dhunës në familje.

Në datën 27 Maj 2009 në mjediset e MPÇSSH-B-së u organizua takimi me përfaqësuesit e OJF-ve për diskutimin e çështjeve kyçe që strategjia do të monitorojë si dhe për të skicuar një listë të treguesve të harmonizuar gjinorë. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i draft listës së treguesve të harmonizuar gjinorë të nevojshëm për monitorimin e angazhimeve të Qeverisë shqiptare për barazinë gjinore, parandalimin e dhunës në familje si dhe mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të grave, me përfaqësues të OJF-ve që kanë ekspertizë në fushën e çështjeve gjinore. Takimi u hap nga Drejtorja e Drejtorisë së

Politikave të Shanseve të Barabarta, Zj. Anna Xheka, e cila pas falënderimit të përfaqësuesve të OJF-ve për pjesëmarrjen e tyre në takim bëri një prezantim të shkurtër të procesit të hartimit të listës së treguesve të harmonizuar gjinorë si dhe hapat që janë ndërmarrë dhe që do të ndërmerren në të ardhmen për finalizimin e kësaj liste në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e UNIFEM-it duke analizuar të 3 fazat e procesit si më poshtë:

- Faza 1 Verifikimi i çështjeve parësore që duhen monitoruar nëpërmjet treguesve të harmonizuar
- Faza 2 Ndarja e treguesve dhe vlerësimi i ekzistencës së të dhënave
- Faza 3 Miratimi i paketës së treguesve të harmonizuar gjinorë dhe angazhimeve/marrëveshjeve për shpërndarjen e informacionit

Ekspertët e UNIFEM-it në fjalën e tyre, bënë një prezantim të shkurtër të punës për vazhdimësinë e procesit të finalizimit të listës së treguesve të harmonizuar gjinorë që ka konsistuar në: a) kontaktimin direkt të pikave të kontaktit, specialistëve të zyrës së statistikave si dhe të përfaqësuesve nga drejtoritë e Monitorimit dhe Analizës së Strategjive Ndërsëktoriale në ministritë e linjës që kanë përgjegjësi në zbatimin e SKBGJ/DHF ose që fokusi i tyre lidhet me 8 drejtimet e saj, për saktësimin më tej të çështjeve kryesore që SKBGJ/DHF do të monitorojë si dhe për



27 Maj, Tiranë

saktësimin e listës paraprake të treguesve, nëpërmjet përmirësimit të atyre ekzistues si dhe propozimit të treguesve të rinj; b) kontaktimin me përfaqësues të drejtorive të ndryshme të INSTAT-it, duke realizuar skanimin e listës paraprake të treguesve në përcaktimin e saktë të kanaleve të mbledhjes së këtij informacioni statistikor si dhe në përcaktimin e boshllëqeve që ekzistojnë në sigurimin e tij.

Më pas, nga ekspertët e përzgjedhur nga UNIFEM-i u prezantuan çështjet kryesore të identifikuar që SKBGJ/DHF do të monitorojë si dhe të treguesve të përzgjedhur sipas 8 fushave të strategjisë.

Në këtë takim, diskutimet e përfaqësuesve të OJF-ve u përqendruan në analizën e treguesve të fushës së arsimit, shëndetësisë, punësimit, çështjeve sociale etj. duke ofruar ekspertizën e tyre në keto drejtime. Pjesëmarrësit kërkuan që



Takimi me përfaqësuesit e OJF-ve për indikatorët gjinorë, 27 Maj

dokumenti i treguesve të harmonizuar gjinorë të shoqërohet edhe me përkufizime të termave apo koncepteve statistikore që janë përdorur në këtë dokument, duke bërë të mundur rritjen e shkallës së kuptueshmërisë dhe të përdorimit të tij nga individë, profesionistë dhe institucione të ndryshme.

Në fund të takimit u vendos që të gjithë pjesëmarrësit t'i rishikojnë edhe një herë me kujdes çështjet që lidhen me treguesit e harmonizuar gjinorë të përcaktuar paraprakisht, duke patur parasysh se ky proces kërkon kohë më të gjatë dhe komentet që mund të kenë për përmirësimin e tyre si dhe propozime të reja t'i dërgojnë me rrugë elektronike në DPSHB dhe në adresën e ekspertëve të UNIFEM-it, në mënyrë që ata të përfshihen në draftin përfundimtar.

4.c. Takim midis përfaqësuesve të MPÇSSHB-së, UNIFEM-it dhe ekspertëve mbi draftin e listës së treguesve gjinorë

Më datë 3 Qershor 2009 në sallën e mbledhjeve të MPÇSSHB-së, u zhvillua takimi me ekspertët e përzgjedhur nga UNIFEM-i, përfaqësuesit e DPSHB-së dhe përfaqësuesit e UNIFEM-it mbi skicën e listës së treguesve të harmonizuar gjinorë.

Në këtë takim u prezantua puna e bërë nga bashkëpunimi i DPSHB-së me ekspertët e UNIFEM-it dhe me pikat e kontaktit të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera të varësisë për çështjet gjinore, për identifikimin e çështjeve kryesore si dhe të treguesve të harmonizuar gjinorë, duke përcaktuar burimet e mundshme të sigurimit të informacionit statistikor si dhe të boshllëqeve që ekzistojnë. Gjithashtu, kjo fazë pune e procesit të përgatitjes së dokumentit të treguesve të harmonizuar gjinorë kishte të bënte edhe me skanimin e listës paraprake të treguesve gjinorë, duke iu referuar strategjive sektoriale në ministritë përkatëse si dhe detyrimeve që rrjedhin nga dokumentat ndërkombëtarë të rëndësishëm, si CEDAW apo Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), etj.

Nga ana e UNIFEM-it u konfirmua që kjo skicë paraprake është konsultuar edhe me organizata të tjera ndërkombëtare si: Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Banka Botërore (BB), Organizata Zviceriane për Zhvillim (OZZH), dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP).

Në lidhje me boshllëqet e identifikuar nga ekspertët e UNIFEM-it u diskutua rreth rrugëve për eliminimin e tyre si dhe për përcaktimin e saktë të burimeve dhe kanaleve të rrjedhjes së informacionit statistikor për përcaktimin e treguesve të harmonizuar gjinorë. Nga diskutimet rezultoi që ky proces kërkon një angazhim të përfaqësuesve të INSTAT-it dhe MPÇSSHB-së për analizën e kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me statistikat dhe programin statistikor që zbaton INSTAT-i.

Në fund të takimit u vendos që të realizohet një takim ndërmjet përfaqësuesve të INSTAT-it, Drejtorisë Juridike në MPÇSSHB dhe UNIFEM-it për përcaktimin e hapave që duhet të hidhen në të ardhmen, në drejtim të sigurimit të kuadrit të plotë ligjor për sigurimin e treguesve të harmonizuar gjinorë.

5. LANÇOHET VROJTIMI I PARË KOMBËTAR "DHUNA NË FAMILJE NË SHQIPËRI"

5.a Dhuna në Familje në Shqipëri: Vrojtimi Kombëtar me bazë Popullatën. Promovim i Institutit të Statistikave (INSTAT) në bashkëpunim me MPÇSSHB për rezultatet e Vrojtimit Kombëtar me bazë Popullatën.

Vrojtimi Kombëtar me bazë Popullatën u realizua në periudhën 2007 - 2008 dhe u lançua me datë 12 qershor 2009, në Tiranë. Takimi u hap nga Zj. Entela Lako, përfaqësuese e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD), e cila bëri një prezantim të shkurtër të procesit të hartimit të raportit: "Dhuna në familje në Shqipëri: Studim kombëtar me bazë popullatën, ku MPÇSSHB është bashkëpunëtorja kryesore për realizimin e tij. Prioritet i këtij raporti është mbledhja e të dhënave për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj

dhunës në marrëdhëniet familjare. Në këtë kuadër, Zj. Turkos-Cosslet, koordinatore rezidente e Kombeve të Bashkuara (KB), përshëndeti këtë ndërmarrje dhe realizimin e saj, duke nënvizuar rëndësinë e veçantë të këtij studimi. Sipas saj "Dhuna në marrëdhëniet familjare është një nga shkeljet më të mëdha të drejtave të njeriut në të gjithë botën". Ajo nënvizoi faktin se: "Të drejtat e njeriut fillojnë në vendet e vogla; të drejtat e njeriut fillojnë në shtëpinë tonë".

Qeveria Shqiptare është angazhuar në një fushatë gjithëpërfshirëse për të parandaluar e luftuar dhunën në familje në përputhje me Fushatën e Këshillit të Evropës, duke ndërmarrë masa konkrete politike e legjislative, për të bërë të mundur mbrojtjen dhe mbështetjen për viktimat dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për çështjet që lidhen me dhunën në familje.

Nga lektorët që morën fjalën shpjeguan se ushtrimi i dhunës në marrëdhëniet familjare në Shqipëri është një dukuri me përmasa shqetësuese, përmasë që vjen në rritje, kryesisht në dekadën e dytë të martesës (30-40 vjeç).

6. TAKIMI ME STUDENTËT E DEPARTAMENTIT TË SOCIOLOGJISË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE

Spektori "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" DPSHB, zhvilloi një takim me studentët e Universitetit të Tiranës, Departamenti i Sociologjisë, ku u trajtua tema me karakter edukativ dhe psikologjik: "Dhuna nuk është çështje kulture, ajo është çështje krimi".

Takimi u realizua në kuadër të punës së DPSHB-së në zbatim të Ligjit Nr. 9669, dt.18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" si dhe të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, në të cilën nënvizohet që "të edukohen fëmijët dhe të rinjtë dhe shoqëria në përgjithësi që dhuna në familje është e papranueshme dhe të aftësohen të

bëjnë zgjedhje të mirëinformuara".

Zhvillimi i këtij takimi u realizua gjithashtu edhe në detyrim të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit nr. 9669, dt.18.12.2006 (i ndryshuar) ndërmjet MPCSSHB-së, MASH, MB, MD, MSH", në nenin 7 të të cilit, në detyrimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nënvizohet:

"Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si Autoriteti Përgjegjës i linjës për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare' (i ndryshuar), nëpërmjet strukturave të saj angazhohet që të orientojë që në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe në të gjitha fakultetet e mësuesisë, të arsimit të lartë publik dhe privat, që trajtimi i problemit të dhunës në përgjithësi dhe i dhunës në familje në veçanti, të bëhet pjesë e kurrikulave të tyre, nëpërmjet moduleve apo të ashtuquajturve cikle leksionesh".



Takimi me studentët e Departamentit të Sociologjisë

Qëllimi i këtij takimi lidhej me ndërgjegjësimin e studentëve mbi pasojat që lindin nga ushtrimi i dhunës në marrëdhëniet familjare dhe që e shqetësojnë seriozisht shoqërinë dhe qeverinë shqiptare, të bindur se ndërgjegjësimi, është një ndër mënyrat më efikase të punës dhe përpjekjeve të përbashkëta për ta luftuar dhunën.

Metodologjia e përdorur bëri të mundur që studentët, të ishin jo vetëm objekt, por edhe subjekt i temës që u trajtua, pasi studentët të sotëm do të jenë sociologët e nesërm, dhe për rrjedhojë dhuna dhe problemet e saj, do të

jenë një nga fokuset e punës së tyre. Në diskutimet dhe pyetjet e ngritura, studentët propozuan se aktivitete apo takime të kësaj natyre të mund të zhvilloheshin më shpesh për efektin ndërgjegjësues dhe informues që kanë.

Në përfundim të takimit studentëve iu shpërndanë materiale të DPSHB-së si buletinë, (botim i DPSHB-së, fletë-palosje "Mbroni veten tuaj nga dhuna në familje", poster: "Mbroni veten tuaj nga dhuna në familje", manualin "Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje" me përmbajtjen e Ligjit Nr.9669, dt.18.12.2006, si dhe botimin: " Ligji për Barazinë Gjinore".

7. FILLIMI I CIKLIT TË TRAJNIMEVE NË TË GJITHË VENDIN MBI LIGJIN NR.9970 "PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI" (BLGJ) DHE KONVENTËN PËR ELEMENIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT KUNDËR GRUAS (CEDAW)

7.a. Trajnimi për Trajnerë (ToT) për LBGJ dhe CEDAW

Në 24-25 Qershor 2009 u organizua trajnimi për trajnerë për Ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri" (BLGJ) dhe Konventën për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (CEDAW). Ky trajnim u organizua nga

DPSHB dhe u mbështet nga UNIFEM-i në kuadrin e "Planit vjetor të Punës (2008 – 2009) së MPCSSHB-së – Për mbështetjen e zbatimit të Programit të Përbashkët të OKB-së për Barazinë Gjinore në Shqipëri".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte fokusimi në rritjen e aftësive të pjesëmarrësve në dy drejtime: a) të kuptuarit më mirë të CEDAW dhe LBGJ për një interpretim dhe zbatim të tyre si një përgjegjësi e re në çështjet e përkatësisë gjinore dhe kundër diskriminimit; b) përmirësimi i teknikave të trajnimit.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve u realizua duke bashkëpunuar me projektin austriak "Barazi në Qeverisje", në kuadrin e të cilit është realizuar krijimi dhe funksionimi i një skuadre trajnuesish për çështjet gjinore, të cilët gjatë vitit 2008 dhe 2009 kanë realizuar një numër të madh trajnimesh nëpër Bashkitë e vendit. Gjitashtu, një pjesë tjetër pjesëmarrësish janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë përvojën e tyre në lidhje me çështjet e përkatësisë gjinore, përvojën si trajnues dhe shtrirjen gjeografike.

Metodologjia dhe teknika e trajnimit e përdorur nga trajnuesit ishte e alternuar në përputhje me objektivat specifike të trajnimit duke synuar:





Trajnimi për Trajnerë mbi LBGJ dhe CEDAW, 24-25 Qershor

- Tërheqjen e vëmendjes së audiencës mbi rolin dhe rëndësinë e LBGJ dhe CEDAW;
- Rritjen e interesit të pjesëmarrësve rreth çështjeve më specifike të LBGJ dhe CEDAW; dhe
- Paraqitja e standardeve dhe koncepteve ndërkombëtare si interpretim i pjesëve të ndryshme të ligjit.

Gjatë trajnimit, nga ekspertët u zbatua një kombinim metodash trajnuese si: paneli – i cili u përdor për të kaluar informacionin nga eksperti në audiencë, dhe disa raporte të anëtarëve të panelit për vëzhgimet e tyre si dhe mënyrën se si ata mendojnë të realizojnë aktivitetet e ardhshme në lidhje me zbatimin e LBGJ dhe CEDAW; Debati, diskutimi i hapur dhe diskutimet në grup të cilat u përqëndruan më shumë në lidhje me zbatimin e instrumentave ndërkombëtarë të ratifikuara nga Shqipëria, ku pjesëmarrësit nxorën në pah vështirësitë e deritanishme të vëzhguara nga ana e tyre; Studimi i çështjes, ku në mënyrë direkte ose jo, ekspertët praktikuan ushtrime të ndryshme.

Trajnimi për Trajnerë (ToT) për LBGJ dhe CEDAW shënon fillimin e një cikli trajnimesh që DPSHB do të organizojë në të gjithë vendin me përfaqësues të: institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, OJF-ve, sistemit gjyqësor, medias etj., për rritjen e ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve në drejtim të njohjes dhe të zbatimit të LBGJ dhe CEDAW si dokumenta të rëndësishëm në drejtim të arritjes së barazisë gjinore.

8. MOMENTE PUNE NE DREJTORINE E POLITIKAVE TE SHANSEVE TE BARABARTA



